

UNIVERSITETI I GJAKOVËS “FEHMI AGANI”

FAKULTETI I MJEKËSISË

DREJTIMI: INFERMIERI



PUNIM DIPLOME

**QËNDRIMET NDAJ PACIENTËVE PSIKIATRIK
(STIGMATIZMI) TEK NXËNËSIT E SHKOLLAVE TË
MESME**

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Naim Jerliu

Kandidatja:

Shqipe Krasniqi

Gjakovë, 2017

FALËNDERIM

E falënderoj profesorin Naim Jerliu për mbështetjen, këshillat dhe informacionet e dobishme që më ndihmuan në përfundimin e kësaj teme.

Një falënderim të singertë për gjithë stafin akademik të Fakultetit të Mjekësisë, veçanërisht Komisionin Vlerësues.

Veç kësaj, ndjej kënaqësi të madhe të falënderoj familjen time për ndihmën dhe mbështetjet e vazhdueshme.

Shqipe Krasniqi

PËRMBAJTJA

Rezymea.....	4
Summary.....	6

Kapitulli -I-

1. Hyrje- Të dhënat historike mbi trajtimin e sëmundjeve mendore.....	8
1.1 Sëmundja mendore dhe stigma.....	9
1.2 Trajtimi i të sëmurëve mendor nga ana e personelit shëndetësor.....	12
1.3 Roli i medias në formimin e qëndrimeve ndaj sëmundjeve mendore.....	13
1.4 Shëndeti mendor në Kosovë - funksionimi i shërbimeve dhe baza ligjore.....	17

Kapitulli –II-

1. Qëllimi i punimit.....	22
2. Metodologjia	23
3. Rezultatet.....	24
4. Diskutim.....	39
5. Përfundimi.....	40
6. Rekomandimet.....	44
7. Referencat.....	45
8. CV e shkurtër.....	46
9. Aneksi.....	47

Rezimeja

Hyrje: Sëmundja mendore është një sëmundje që shkakton çrregullim në mendim dhe/ose në sjellje, gjë që sjell paaftësi për të përballuar kërkesat normale të jetës dhe rutinën e përditshme. Problemet e shëndetit mendor mund të lidhen me stresin e rëndë të shkaktuar nga një situatë e veçantë apo disa ngjarje. Ku sëmundjet mendore janë fizike, emocionale dhe psikologjike. Stigma përdoret për të përshkruar qëndrimet personale ose kolektive ndaj personave me probleme të shëndetit mendor ose me çrregullime të shëndetit mendor ku stigma e kategorizon dikë si të ndryshëm nga të tjerët, me pasojë duke nënvlerësuar personin.

Qëllimi: Qëllimi i këtij punimi është që të kuptohen qëndrimet e nxënësve të shkollave të mesme ndaj pacientëve psikiatrik (stigmatizmi), përkatësisht sjelljet e njerëzve ndaj pacientëve me probleme mendore dhe trajtimit të tyre.

Materiali dhe Metodati: Studimi përbëhet nga dy komponenta: Shqyrtimi i literaturës në lidhje me sëmundjen mendor dhe stigmatizmi si pasojë e sëmundjes, dhe vlerësimi i perceptimeve të adoleshentëve mbi stigmatizmin tek personat me probleme të shëndetit mendor në qytetin e Prizrenit. Me qëllim që të kuptojmë njohuritë e adoleshentëve mbi sëmundjet mendore dhe stigmën si koncept realizuam anketën e cila përmbanë pyetje të cilat na mundësuan të kuptojmë se sa nxënësit dinë rreth stigmës, sa pranojnë apo pranojnë në shoqëri një individ me sëmundje mendore. Anketa u realizua me 120 nxënës të shkollës së mesme 'Luciano Motroni' Prizren, duke përfshirë nga 40 nxënës në 3 drejtime të ndryshme të mjekësisë.

Rezultatet: Rreth 50% të nxënësve të drejtimit infermieri mendojnë që ndoshta çdo njeri mund të ketë probleme të shëndetit mendor duke mos qenë të sigurt në përgjigje definitive. Poashtu kështu mendojnë edhe 50% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 60% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Fatkeqësisht, shumica e nxënësve mendojnë apo kanë marrë njohuri të pasakta në lidhje me sëmundjen mendore duke pohuar se me sëmundjen mendore mund të preken vetëm të rriturit e jo fëmijët dhe adoleshentët duke përfshirë 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 55% nga drejtimi mami dhe 30% nga drejtimi farmaci. Shumica e nxënësve nga tre drejtimet e mjekësisë mendojnë se ndoshta individët me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës, duke përfshirë 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Përfundimi: Mbështetur në rezultatet e këtij studimi është e nevojshme të përgatiten programe edukimi dhe trajnimi të vazhdueshëm duke përfshirë jo vetëm nxënësit e shkollave të mesme por të gjithë adoleshentët në përgjithësi me qëllim të ndryshimit të mendimit dhe perceptimeve në lidhje me sëmundjet mendore. Duhet kuptuar se informacionet që thithen nga mediat në lidhje me sëmundjet mendore nuk janë gjithmonë të vërteta, prandaj duhet gjetur dhe ofruar më tepër mundësi që të kuptohet e vërteta, duke pasur parasysh që informacionet që kemi mund të ndikojnë në lidhje me raportet që kemi në shoqëri.

Summary

Introduction: Mental illness is a disease that causes disorders in thought and / or behavior, which leads to inability to cope with normal life expectancy and daily routine. Mental health problems can be related to severe stress caused by a particular situation or some event. Where mental illnesses are physical, emotional, and psychological. Stigma is used to describe personal or collective attitudes towards persons with mental health problems or mental health disorders where the stigma categorizes someone other from others, resulting in the underestimation of that person

Purpose: The purpose of this paper is to understand the attitudes of high school students to psychiatric patients (stigmatism), respectively the behavior of people towards mental patients and their treatment.

Material and Methods: The study consists of two components: Literature review of mental illness and stigmatization as a result of the disease, and assessment of adolescent perceptions of stigmatism in persons with mental health problems in the city of Prizren. In order to understand the knowledge of teenagers about mental illness and stigma as a concept, we conducted a survey that contained questions that made it possible to understand how much students know about the stigma and how an individual with mental illness is accepted or adopts in society. The survey was conducted with 120 medical high school students of "Luciano Motroni"- Prizren, including 40 students in 3 different disciplines of medicine.

Results: 50% of the infirmery discipline students think that maybe every person can have mental health problems by not being sure in a definitive answer, so do about 50% of midwifery discipline students think and 60% of the students from pharmacy discipline. Unfortunately, most students including 40% of nursing students, 55% of midwives and 30% from pharmacy

discipline think or have acquired inaccurate knowledge of mental illness, claiming that mental illness can be affected only to adults, and not by children and adolescents. "Perhaps people with mental illness suffer from their symptoms throughout their lives," most of the students think, from 3 directions of medicine, including 40% of nursing students, 35% of midwifery students, and 25% of pharmacy students.

Completion: Based on the results of this study, it is necessary to prepare continuing education and training programs involving not only high school students, but all teenagers in general, in order to change their mindset about mental illness, we must understand that information which we absorb from the media about mental illnesses are not always true so we have to study more to really understand, considering the information that may affect our relationships in society.

1. Hyrje

Të dhënat historike mbi trajtimin e problemeve mendore

Njerëzit e lashtësisë besonin se çdo sëmundje ishte shenjë e pakënaqësisë së zotave dhe në vetvete ishte ndëshkim për mëkatarët dhe ata që kishin bërë gabime. Ata me sëmundje mendore konsideroheshin ose si hyjnorë ose si demonë, në varësi të sjelljes së tyre. Individët që shiheshin si demonë izoloheheshin, ndëshkoheshin dhe ndonjëherë digjeshin në zjarr. Më vonë Arsitoteli (382- 322 PK) tentoi të lidhte çrregullimet mendore me çrregullime fizike dhe zhvilloi teorinë e tij se sasia e gjakut, ujit dhe bilës së zezë e të verdhë në trup kontrollonte emocionet.

Në kohët e hershme të Kristianizmit (1- 1000 PK) besimet dhe superticionet i adresoheshin demonëve dhe të sëmurët mendorë shiheshin si të pushtuar nga djalli.

Priftërinjtë aplikonin ekzorcizmin (metodat të largimit të shpirtit të keq) për të hequr qafe shpirtin e djallit. Kur kjo dështonte, ata përdornin metoda më të ashpra të tilla si: mbyllja në biruca (dhoma të nëndheshme), rrahje me kamxhik, futje në gjendje urie dhe trajtime të tjera të ngjashme.

Gjatë epokës së Rilindjes (1300- 1600), njerëzit me sëmundje mendore u veçuan prej kriminelëve në Angli. Ata që konsideroheshin të padëmshëm lejoheshin të dilnin nëpër fshatra ose të jetonin në zonat rurale, kurse ata që konsideroheshin ' lunatikë të rrezikshëm' futeshin në burg, lidheshin me zinxhirë dhe liheshin të vdisnin nga uria.

Në 1547, Spitali i Shën Mërisë në Bethlehem u shpall zyrtarisht spital për marrëzinë që u quajt 'çmendina ', i pari i llojit të vet. Që nga viti 1775, ata që vizitonin institutin paganin për të patur mundësinë të shihnin pacientët, apo qoftë edhe për vizitë dhe për t'u zbavitur duke parë të sëmurët të cilët konsideroheshin si kafshë, jo si qenie njerëzore. Gjatë së njëjtës periudhë në kolonitë (të cilat më vonë u quajtën SHBA), të sëmurët mendorë konsideroheshin si djaj, ose me shpirt të zaptuar prej djallit dhe për këtë ndëshkoheshin. Ata turtroheshin, madje edhe digjeshin në turrën e druve.¹

1 Fatime Elezi, Eugjen Sotiri, Sonila Tomori, Florida Dobi 'Bazat e psikiatrisë', Cap - 1 -. Kujdesi infermieror në shëndetin mendor, fq. 18- 19, Tiranë, 2012.

1.1 Sëmundja mendore dhe stigma

Sëmundja mendore është një sëmundje që shkakton çrregullime në mendim dhe/ose në sjellje, gjë që sjell paaftësi për të përballuar kërkesat normale të jetës dhe rutinën e përditshme. Këto çrregullime mund të jenë nga më të lehtat deri te më të rëndat.

Simptomat që i shoqërojnë këto sëmundje janë ndryshimet në humor, personalitet, zakonet personale dhe/ose tërheqja nga jeta sociale. Problemet e shëndetit mendor mund të lidhen me stresin e rëndë të shkaktuar nga një situatë e veçantë apo disa ngjarje. Ashtu si tumoret, diabeti apo sëmundjet e zemrës, edhe sëmundjet mendore janë fizike, emocionale dhe psikologjike.

Sëmundjet mendore mund të shkaktohen si pasojë e stresit që vjen nga mjedisi, faktorët gjenetikë, disbalancat biokimike në tru, ose kombinimi i dy ose më shumë faktorëve që u përmendën. Me kujdesin dhe trajtimin e duhur shumë individë mësojnë si ta përballojnë sëmundjen apo shërohen nga një sëmundje mendore apo çrregullim emocional.²

Shëndeti mendor ndikohet nga 3 faktorë bazë.

- Së pari, niveli i faktorëve përcaktues ekonomikë, psikosocialë dhe ambientalë të shëndetit të cilët kanë ndikim madhor mbi mirëqenien e njerëzve dhe ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor.
- Së dyti, stigmatizimi i vazhdueshëm ndaj çrregullimeve mendore që lë shumë pacientë nën kujdesin e shërbimeve, me pasojë në kohëzgjatjen e ndërhyrjeve, humanizimin e shërbimeve dhe riintegrimin e të sëmurëve mendorë në shoqëri.

² Bukuroshe Hila, 'Shëndeti mendor dhe sistemi i drejtësisë penale', Tiranë- Shqipëri.

- Së treti, kushtet e lidhura me stresin dhe mungesën e shpresës, si depresioni, vetëvrasja, alkoolizmi, dhe sjelljet e dhunshme dhe të rrezikshme, të cilat vazhdojnë të kenë një ndikim të rëndësishëm në sëmundshmërinë.

Pengesa kryesore me të cilën duhet të përballemi në komunitet është stigma dhe diskriminimi i lidhur me të kundrejt personave që vuajnë nga çrregullimet mendore. Stigma përdoret për të përshkruar qëndrimet personale ose kolektive ndaj personave me probleme të shëndetit mendor ose me çrregullime të shëndetit mendor ku stigma e kategorizon dikë si të ndryshëm nga të tjerët, me pasojë nënvlerësimin e atij personi. Në përshkrimin e tij klasik të 1963, Goffman e përkufizon stigmën si “një aspekt thellësisht përulës”, me anë të të cilit një person reduktohet “nga një individ i plotë”.

Pra, stigma është “situata në të cilën ndodhet një individ që është i skualifikuar nga pranimi i plotë shoqëror”. Megjithëse problemet e shëndetit mendor hasen gati në çdo familje, personat që i përjetojnë këto probleme vazhdojnë të ndeshen me frikën dhe paragjykimet e të tjerëve, të cilat i bëjnë të ndihen të turpëruar dhe të përjashtuar. Stigma dhe diskriminimi që lidhen me përjetimin e një sëmundjeje mendore janë shpesh kaq shkatërruese sa i pengojnë njerëzit që të kërkojnë ndihmë nga frika se mos etiketohen. Stigma në shëndetin mendor është një ndër pengesat kryesore drejt parandalimit të hershëm dhe trajtimit, si dhe ripërfshirjes së personave që përjetojnë probleme të shëndetit mendor në shoqëri.

Stigma manifestohet në nivel konjitiv, emocional dhe praktik:

- Në nivel konjitiv (mendimesh), stigma paraqitet në formë stereotipi. Stereotipet janë mendime dhe qëndrime të përgjithshme, të lidhura me grupe përkatëse, etnike dhe fetare. Stereotipet janë mendime të ngurta të cilat vështirë se ndryshojnë mbi bazën e përvojës. Nga stereotipet krijohen edhe paragjykimet që lidhen me njohuri të pamjaftueshme mbi një dukuri apo

sëmundje, si dhe me mohimin dhe mungesën e interesit për zgjerimin e njohurive mbi dukurinë apo sëmundjen. Në këtë mënyrë, stigma është e lidhur me paragjykimet.

- Në nivel emocional, stigma manifestohet përmes emocioneve (ndjenjave) si për shembull frikë nga personat me çrregullime mendore, ose ndjenja e turpit që personat me probleme të shëndetit mendor dhe familjarët e tyre ndjejnë si pasojë e paragjytimeve të shoqërisë.
- Në nivel praktik stigma manifestohet nëpërmjet diskriminimit, që janë sjelljet dhe veprimet që individët, organizatat ose shteti ndërmarrin në bazë të qëndrimeve stigmatizuese. Stigma mund të paraqitet në forma të ndryshme në grupe të ndryshme shoqërore. Ajo mund të jetë pjesë përbërëse e qëndrimeve të popullatës së përgjithshme, e vetë personave me probleme të shëndetit mendor, e profesionistëve dhe e politikëbërësve.

Qëndrimet negative përfshijnë ngjyrosjen e të gjithë të sëmurëve mendorë si të deklasuar, të dhunshëm, vrasës, të paafte, të pashërueshëm, të pamoralshëm, të pamotivuar ose të papërshtatshëm, si dhe pasqyrimin e tyre në media si të paparashikueshëm dhe të dhunshëm.

Këto pengesa të bazuara në qëndrime kanë ndikim negativ mbi marrëdhëniet shoqërore dhe familjare, punësimin, strehimin, përfshirjen sociale, vetëvlerësimin, dhe pakësojnë mundësitë e aksesit në shërbime. Stigmatizimi nga profesionistët e shëndetit – rezultatet e shumë studimeve tregojnë se profesionistët e shëndetit kanë qëndrime të ngjashme me ato të popullatës së përgjithshme kundrejt personave me probleme të shëndetit mendor. Ndryshimi i qëndrimeve stigmatizuese të popullatës së gjerë do të ketë si pasojë dhe reduktimin e stigmës së përjetuar nga personat me probleme të shëndetit mendor, si dhe asaj të ushtruar nga profesionistët e shëndetësisë dhe politikëbërësit.³

3 OBSH (Zyra për Shqipëri), Studimi kombëtar mbi qëndrimet e publikut ndaj shëndetit mendor, Tiranë- Shqipëri, 2009.

1.2 Trajtimi i të sëmurëve mendor nga ana e personelit shëndetësor

Në përgjithësi shumë nga këta pacientë nuk kanë dëshirë të vizitohen dhe shtrohen në institucione psikiatrike. Kjo ndodh edhe me familjarët e tyre dhe kjo për arsye se këto sëmundje në popull kanë nam të keq. Në këtë drejtim, druhen më shumë të rinjtë dhe të rejtat, sepse kjo mund t'i rrezikojë të ngelen pa u martuar. Për pasojë, pacientë të tillë shpesh fshihen, nuk vizitohen e nuk shtrohen, por sëmundja përparon duke rrezikuar edhe individualizimin e tyre.

Një shkak i ndrojtjes është edhe tallja nga njerëz dashakeq. Mendimet dhe paragjykimet lidhur me këto sëmundje, e kanë burimin në disa faktorë të tillë, si :

- Prej injorancës të sëmurët mendorë janë trajtuar nga populli si ' njerëz të shejtanit '.
- Keq ka ndikuar edhe mjekimi joefikas dhe kronik i tyre, që i kthente këta njerëz të paaftë për punë, shoqëri e familje.
- Mendohet se në përgjithësi këto sëmundje janë të trashëgueshme dhe gati të pashërueshme.

Nga pikpamja psikologjike këta pacientë kërkojnë një trajtim me shumë takt. Për ta janë të palejshme ironizimet e talljet, sepse janë pacientë që kanë nevojë për shumë ngrohtësi dhe bashkëpunim të ngushtë me familjarët.

Njeriu i shëndetësisë nga këta të sëmurë nuk duhet të kenë frikë, sepse ata nuk janë agresiv, të tillë mund të bëhen vetëm kur ngacmohen. Madje, atyre ju vjen rëndë kur konstatojnë se njerëzit e shëndetësisë kanë frikë prej tyre dhe e kundërta, ndihen shumë mirë kur trajtohen si të tjerët. Mjekut dhe infermierit nuk i lejohet që për ta të flasin poshtë e lart. Nga ana e familjarëve, njerëzve të shëndetësisë që punojnë në pavionet e psikiatrisë, shpesh u drejtohet një pyetje e tillë

- A duhet të martohet sa më parë një i ri me sëmundje psikike ?

Përgjigjja do të ishte: së pari, jeta seksuale të këta të sëmurë nuk ndikon mirë. Së dyti, të sëmurët e sapo trajtuar nuk duhet të martohen menjëherë, jo vetëm për telashet e martesës, por edhe sepse nuk përjashtohet ndikim negativ në familjen e ardhshme. Përvoja ka treguar se këto janë martesa të shpejtuara dhe jo me baza dashurie të vërtetë.⁴

Stigma dhe diskriminimi pengojnë përmirësimin e gjendjes së këtyre njerëzve, mund të përkeqësojnë simptomat e problemit të tyre të shëndetit mendor, si dhe i pengojnë këta njerëz që të kërkojnë ndihmën e duhur dhe në kohën e duhur. Stigma dhe diskriminimi i personave me probleme të shëndetit mendor prek çdo aspekt të jetës së tyre të përditshme si p.sh punësimin, kujdesin shëndetësor fizik dhe mendor, banimin, jetën familjare, etj.⁵

1.3 Roli i medias në formimin e qëndrimeve ndaj sëmundjeve mendore

4 Gjergji M. Aleksi, Pirro Prifti, Vetima Murzaku, ' Psikologjia, Etika, Deontologjia mjekësore '. Cap – VII-. Aspektet psikologjike të zhvillimit të moshave njerëzore të ndryshme, normale dhe si pacientë të mjekësisë, fq. 114- 115, Tiranë, 2003.

5Dita Botërore e Shëndetit Mendor, Tetor, 2013

http://www.ishp.gov.al/multimedia/Kalendari_2013/Dita%20Boterore%20e%20Shendetit%20Mendor.pdf

Sqarimi i mënyrës në të cilën mediat informojnë dhe keqinformojnë publikun në një fushë të tillë si sëmundja mendore është veçanërisht e rëndësishme sepse kuptimi i komunitetit për sëmundjet mendore është më pak se optimale dhe stigma dhe diskriminimi nuk janë të rralla.

Mediat janë një burim i rëndësishëm informacioni mbi sëmundjet mendore, si për popullatën e përgjithshme ashtu edhe për njerëzit me sëmundje mendore;

Prezantimi i imazheve negative të sëmundjeve mendore si në media ashtu edhe në mediat jofikse rezultojnë në zhvillimin e besimeve më negative dhe të pasakta në lidhje me sëmundjen mendore.⁶

Mënyra se si mediat i portretizojnë sëmundjet mendore është diçka e cila ndikon shumë tek individët të perceptimi mbi shëndetin mendor. Imazhe të shtrembëruara dhe poshtëruese mbi sëmundjet mendore, të paraqitura për publikun ndikon në perceptimin pastaj dhe sjelljen e personave që e ndjekin median. Kur këto imazhe janë të pafavorshme dhe të pasakta siç ndodh shpesh, ata kontribuojnë në stigmën dhe diskriminimin që përfaqësojnë pengesat për trajtimin dhe shërimin e pacientëve me sëmundje mendore. Filma, televizion, artikuj gazetash dhe libra shpesh i paraqesin njerëzit me sëmundje mendore si të paparashikueshme, të rrezikshme dhe të dhunshme. Në filma njerëzit me sëmundje mendore paraqiten duke kryer krime të dhunshme ku ai karakter është quajtur "i çmendur" dhe kështu konsiderohet "një rrezik për këdo që kalon atë."

Shumë shpesh, mediat përdorin terme që tentojnë të përjetësojnë mitet dhe stereotipet lidhur me sëmundjet mendore, duke nxitur frikën në komunitet dhe të çojë në përfundime të papërgjegjshme duke mos kuptuar se mungesa e njohurive në lidhje me sëmundje mendore mund të shkaktojë frikë të panevojshme në popullatë. Personat e identifikuar si të sëmurë mendorë janë të përfaqësuar shumë shpesh nga mediat si version laik të djallit, të çmendur. Mirëpo në realitet, sëmundja mendore është një parashikues i dobët i dhunës. Shumica e njerëzve të cilët janë të dhunshëm nuk vuajnë nga sëmundjet mendore. Si një grup, të sëmurët mendorë nuk janë më të dhunshme se çdo grup tjetër. Në fakt, njerëzit me sëmundje mendore kanë shumë më shumë gjasa të jenë viktimë të dhunës se sa të jenë të dhunshëm vetë.

Hulumtimi i tanishëm tregon se njerëzit me sëmundje të mëdha mendore janë dy herë e gjysmë më shumë gjasa të jenë viktimë të dhunës sesa anëtarët e tjerë të shoqërisë. Është vlerësuar se një në çdo katër persona me sëmundje mendore do të jetë viktimë e dhunës çdo vit, një normë që është njëmbëdhjetë herë më e lartë se norma e viktimizimit të dhunës e përjetuar nga popullata e përgjithshme. Njerëzit me sëmundjet mendore nuk kanë pjesë në shumicën e krimeve të dhunës të kryera në shoqërinë tonë. Supozimi se çdo sëmundje mendore mbart me vete një potencial të

⁶Mindframe-media, 'Sëmundja mendore në media', Prill, 2012

caktuar për dhunë është vërtetuar se është e gabuar në shumë studime. Studimet e fundit kanë treguar se alkooli dhe abuzimi i substancave tani peshojnë më shumë se sëmundjet mendore për të kontribuar në dhunë.

Në 1996, Health Canada ka bërë rishikimin i artikujve shkencorë duke gjetur se parashikuesi më i fuqishëm i dhunës dhe sjelljes kriminale nuk është një sëmundje mendore, por historia e kaluar e dhunës dhe kriminalitetit. Faktorë të tillë si mosha, gjinia, abuzimin e substancave dhe nivelit arsimor janë kontribuesi të dhunës në mënyrë të konsiderueshme më shumë sesa çrregullimet mendore. Kushtet të cilat rrisin rrezikun e dhunës janë të njëjta nëse një person ka një sëmundje mendore apo jo.

Në një raport të vitit 1999 një kirurg i përgjithshëm mbi shëndetin mendor ka indentifikuar stigmën si një nga pengesat më kryesore për të përmirësuar kujdesin shëndetësor mendor, duke vënë në dukje se "Stigma tragjikisht i privon njerëzit nga dinjteti i tyre dhe ndërhyr me pjesëmarrjen e tyre të plotë në shoqëri". Stigma në lidhje me njerëzit me sëmundje mendore mund të kuptohet si një kombinim i problemeve të njohurive (injurancës), qëndrimet (paragjykimet) dhe sjellje (diskriminim). Stigma i referohet një qëndrimi, diskriminimi është sjellja e krijuar nga ky qëndrim.

Stigma është e rëndë. Vet çrregullimi psikiatrike është i dhimbshme mirëpo dërmuese është e përrbuzja e njerëzve të tjerë, prandaj njerëzit me sëmundje mendore e pëlqejnë shmangien. Shumica e njerëzve me probleme të shëndetit mendor pranojnë se stigma që shoqëron sëmundjet mendore është më e keqe sesa vetë sëmundja. Jo vetëm që është e vështirë për ata që të përballen me çrregullime mendore mirëpo detyrohen të përballen edhe me një botë që keqkupton dhe zhvlerëson atë. Stigma gjithashtu ka fuqinë për të zvogëluar kërkimin për trajtim. Ata që janë të gatshëm të pranojnë çrregullime tyre kanë gjasa të vonojë ose të mos kërkojnë ndihmën e duhur (psikiatrike).

Stigma mbi sëmundjen mendore gjithashtu çon në diskriminimin për strehim dhe redukon mundësitë për punësimi. Kushtet adekuate dhe të shëndetshme të jetesës janë të favorshme për të përmirësuar funksionimin mendor. Njerëzit me sëmundje mendore mund të kenë vështirësi gjatë jetës së tyre për të siguruar arsimim dhe punësim të përshtatshëm për shkak të pengesave të tilla si stigma dhe diskriminimi. Si rezultat, individët me një sëmundje mendore shpesh zhyten në varfëri. Mungesa e strehimit të përballueshëm, të ardhurat e pamjaftueshme, dhe përjashtimit nga arsim cilësor dhe punësimi të largon nga jetesa normale me individët.

Qëndrimet dhe përshtypjet e publikut rreth çështjeve që lidhen me sëmundje mendore janë në masë të madhe të formuar nga modelet e vazhdueshme negative që krijohen nga mediat. Mediat janë burimi parësor për publikun në lidhje me njerëzit mbi identifikimin e njerëzve si të sëmurë mendor. Për mirë apo për keq, media në shoqërinë tonë formon idetë tona të asaj botës dhe antarët e saj. Rezultati përfundimtar është se publiku i mendon njerëzit me sëmundje mendore

si një grup "tjetër" ose lloj tjetër i njerëzve, dhe kjo krijon një barrierë shtesë për komunikim dhe për t'i kuptuarit ku kjo krijon kushte perfekte për stigmën.

Ne kemi nevojë, si shoqëri, që të vazhdojmë të përpiqemi për të zvogëluar dhe për të eliminuar stigmën dhe diskriminimi. Njerëzit mund të shërohen nga sëmundje mendore, nëse kanë mbështetje dhe shërbime të nevojshme për të lehtësuar dhe të ushqejë një ndjenjë shprese dhe një besim se nesër do të jetë më mirë se sot.⁷

Njerëzit me sëmundje mendore nuk mund të shërohen. "Rimëkëmbja shfaqet rrallë" në media, shkruan Wahl. "Kur njerëzit shkojnë në spitalet psikiatrike, ata rrallë bëhen më të mirë." Dhe nëse ata bëhen më mirë, shton ai, "mjafton që ata të jenë të stabilizuar, por jo aq sa ... ata "Jeni të integruar me botën dhe keni miq dhe vende pune". Mesazhi që rezulton, thotë ai, është se individët me sëmundje mendore nuk kanë shpresë për një jetë "normale".

Realiteti është se kjo nuk është e vërtetë: Ekspertët thonë se jo vetëm pacientët shpesh marrin veten nga sëmundjet psikiatrike, por mund të jetojnë jetën shëndetësore me ndihmën e medikamenteve, terapisë dhe rrjeteve mbështetëse.⁸

Filmat kanë një ndikim të madh në besimet popullore në shoqërinë amerikane. Imazhet dhe idetë në filma absorbohen pa vështirësi në imagjinatën popullore. Ky efekt mund të lë përshtypje të gjata. Filmat mund të frymëzojnë njerëzit për të rritur ndërgjegjësimin për çështje të ndryshme si sëmundja mendore, por mund të çojë në supozime të pasakta dhe stigmatizëm. Në këtë tezë përshkruhet për median dhe për portretizimin e sëmundjes mendore dhe veçanërisht se si sëmundja mendore mund të hidhet në një dritë negative me pak efekte pozitive.⁹

7 Kismet Baun, 'Roli i mediave në formimin e qëndrimeve ndaj sëmundjeve mendore', 2009.

8 Kristin Fawcett, 'Si keqinterpretohet sëmundja mendore në media? ', Prill, 2015.

9 Yanca Aracena, Një analizë e stigmës dhe portretizimi në filma, New York, 2012.



Fig.1. Shëndeti mendor dhe ndikimi i stigmës.

Shëndeti mendor në Kosovë - funksionimi i shërbimeve dhe baza ligjore

Reforma e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë në bazë të Planit Strategjik (2001) shënoi rezultate fillestare inkurajuese. U themelua Shërbimi Profesional i Shëndetit Mendor të Kosovës me shtatë struktura administrative të ndërlidhura në mënyrë funksionale, që me sukses filloi të ofron shërbime të shëndetit mendor të mbështetura në forcat përballuese të individit, familjes dhe bashkësisë së gjerë. Mirëpo, nevojat e mëdha në rrafshin e shëndetit mendor, kufizimet serioze buxhetore, vështirësitë në integrimin e shërbimeve spitalore dhe jashtëspitalore të shëndetit mendor, si dhe riorganizimi i Entit Special në Shtime si pjesë funksionale e Shërbimit të Shëndetit Mendor të Kosovës, imponuan nevojën për hartimin e planit të ri strategjik të shëndetit mendor të Kosovës 2008– 2013. Vizion i Strategjisë është sigurimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse të shëndetit mendor për të gjithë banorët e Kosovës, të mbështetura në fuqitë individuale të klientit, aftësitë përballuese të familjes së tij, dhe resurset e bashkësisë ku jeton; në

pajtim me veçoritë kulturore të popullatës dhe mundësitë reale ekonomike dhe financiare të vendit; me theks të veçantë në luftimin e stigmës ndaj të sëmurëve psikiatrik dhe çfarëdo diskriminimi. Mision i Strategjisë është përparimi i mëtutjeshëm i sistemit të integruar dhe funksional të shërbimeve të shëndetit mendor, që disponon me resurse të mjaftueshme institucionale dhe profesionale për uljen e prevalencës së çrregullimeve dhe sëmundjeve psikiatrike, si dhe sigurimin e dinjitetit, integritetit dhe mëvetësisë së shfrytëzuesve të shërbimeve, nëpërmjet: parandalimit efektiv; trajtimit gjithëpërfshirës multidisciplinar, të vazhdueshëm dhe me qasje të lehtë, të mbështetur në të dhëna shkencore; si dhe rehabilitimit adekuat psikosocial, të mbështetur në aftësitë përballuese të familjes dhe të mjedisit përkatës social.

Qëllimet e Strategjisë janë:

1. Shërbimet e integruara dhe funksionale të shëndetit mendor, që sigurojnë përmbushjen e standardeve të shërbimit të shëndetit mendor të Kosovës dhe OBSH-së1.
2. Monitorimi, mbikqyrja dhe vlerësimi i rregullt i praktikave të punës së këtyre shërbimeve, nëpërmjet mbledhjes, analizës, dhe raportimit të rregulltë të informatave relevante.
3. Legjislacioni gjithëpërfshirës dhe funksional, që me prioritet rregullon: çështjen e hospitalizimeve dhe trajtimeve të detyruara, procesin e deinstitutionalizimit dhe sigurimin e të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

Objektivat dhe aktivitetet e Strategjisë sipas qëllimeve dhe objektivave të parashtruara, janë:

1.1. Parandalimi efektiv i çrregullimeve dhe sëmundjeve psikiatrike.

1.1.1 Bashkëpunimi me shkollat fillore dhe të mesme, publike dhe private, në kuadër të strategjisë së shkollave për promovimin e shëndetit.

1.1.2 Bashkëpunimi i strukturave administrative të Shërbimit profesional të shëndetit mendor të Kosovës (SHPSHMK) me bashkësitë fetare, individët e regjistruar që ofrojnë shërbime paramedicinale në lëminë e shëndetit mendor, dhe organizatat relevante joqeveritare.

1.1.3 Bashkëpunimi i strukturave administrative të SHPSHMK me shërbimet e mirëqenies sociale; shërbimet e punëve të brendshme dhe të sigurisë, sistemin gjyqësor dhe sistemin penal korrektues.

1.2 Trajtimi gjithëpërfshirës, i vazhdueshëm dhe me qasje të lehtë i mbështetur në të dhëna shkencore.

1.2.1 Organizimi i SHPSHMK, në shtatë struktura administrative, në bazë territoriale, të afta që t'u përgjigjen shumicës së nevojave të popullatës në lëminë e shëndetit mendor në territorin përkatës; si dhe themelimi i Qendrës për integrimin dhe rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime si strukturë e veçantë administrative e SHPSHMK.

1.3 Rehabilitimi i suksesshëm psikosocial i shfrytëzuesve të shërbimeve të SHPSHMK.

1.3.1 Mbështetja e procesit të de-institucionalizimit të sëmurëve kronik psikiatrik nga: spitalet psikiatrike jashtë Kosovës², repartet psikiatrike në klinikën e psikiatrisë dhe spitalet rajonale, Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të sëmurëve kronik psikiatrik në Shtime, dhe Shtëpitë për Integrim në Bashkësi.

1.3.2 Funkcionalizimi i të drejtave të sëmurëve psikiatrik në lëminë e mbrojtjes sociale.

1.3.3 Themelimi i kapaciteteve resocializuese, në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, për trajnime vokacionale dhe punësimin e të sëmurëve kronik psikiatrik, me qëllim të fuqizimit të rolit të tyre aktiv.

1.3.4 Bashkëpunimi institucional ndërmjet SHPSHMK, shërbimeve të mirëqenies sociale, dhe organizatave relevante joqeveritare.

1.3.5 Programet e psikoedukimit në grupe shumëfamiljare sipas temave të caktuara.

1.4 Ngritja e kapaciteteve udhëheqëse në SHPSHMK, përfshirë udhëheqësit e reformës në lëmitë specifike të shëndetit mendor dhe menaxherët e strukturave të veçanta administrative.

1.4.1 Planifikimi adekuat buxhetor, në bazë të parametrave relevant, me synim të çvendosjes së shpenzimeve buxhetore nga repartet psikiatrike spitalore kah shërbimet në komunitet.

1.4.2 Themelimi i Sektorit të shëndetit mendor në Ministrinë e Shëndetësisë dhe sigurimi i përgjegjësisë administrative të drejtorëve të strukturave administrative të SHPSHMK ndaj udhëheqësit të këtij sektori.

1.4.3 Sigurimi i trajnimeve relevante menaxheriale për stafin udhëheqës të SHPSHMK.

1.5 Koordinimi ndërsektorial i shërbimeve të shëndetit mendor me shërbimet e mirëqenies sociale, shërbimet e punëve të brendshme, shërbimet gjyqësore, sistemin penal, korrektues dhe shërbimet përkatëse në sektorin joqeveritar.

1.5.1 Institucionalizimi i bashkëpunimit të SHPSHMK me shërbimet jashtë sektorit të shëndetësisë.

1.5.2 Programet e trajnimeve të përbashkëta të profesionistëve të SHPSHMK me punëtorët e shërbimeve përkatëse të mirëqenies sociale, të punëve të brendshme, të shërbimeve gjyqësore, të sistemit penal dhe korrektues, si dhe me mësimdhënësit në Fakultetin e Mjekësisë dhe në Departamentin e Psikologjisë të Universitetit të Prishtinës.

1.6 Zhvillimi i bashkëpunimit profesional dhe shkencor me institucione vendore dhe ndërkombëtare akademike, përfshirë financimin nga buxheti i Kosovës.

1.6.1 Bashkëpunimi institucional me asociacionet profesionale dhe shkencore, vendore dhe ndërkombëtare, në sektorin qeveritar dhe joqeveritar.

1.6.2 Përcaktimi i projekteve prioritare hulumtuese në lëminë e shëndetit mendor.

1.6.3 Mbështetja e anëtarësimit të asociacioneve profesionale vendore në asociacionet përkatëse rajonale dhe ndërkombëtare.

2.1 Zhvillimi i shërbimit për mbledhjen, analizën dhe raportimin e rregulltë të të dhënave statistikore përkitazi me funksionimin e SHPSHMK, në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

2.1.1 Instalimi i sistemit elektronik të mbledhjes së të dhënave në të gjitha strukturat administrative të SHPSHMK, pjesë e sistemit të unifikuar të informimit shëndetësor.

2.1.2 Përgatitja e formularit të veçantë për mbledhjen e të dhënave në SHPSHMK.

2.1.3 Përgatitja e sistemit të raportimit të rregulltë të të dhënave në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK), çdo muaj.

2.1.4 Themelimi i sistemit të analizës së të dhënave në IKSHPK dhe raportimi i tyre i rregulltë, çdo tre muaj, në Zyren e Shëndetit Mendor, të Ministrisë së Shëndetësisë.

2.1.5 Përgatitja e raportit vjetor të IKSHPK mbi gjendjen e shëndetit mendor të popullatës së Kosovës dhe mbi shërbimet e ofruara nga SHPSHMK.

2.2 Vlerësimi i shërbimeve të SHPSHMK nga Ministria e Shëndetësisë, organizatat relevante joqeveritare dhe anëtarët e shoqërisë civile që kujdesen për mirëqenien e shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendor.

3.1 Përgatitja e Ligjit të Shëndetit Mendor të Kosovës.

3.1.1 Përgatitja e Memorandumit sqarues për arsyeshmërinë e nxjerrjes së Ligjit të shëndetit mendor.

3.2 Monitorimi i respektimit të të drejtave të shfrytëzuesve të shërbimeve të shëndetit mendorë; të dinjitetit, të autonomisë dhe të mëvetësisë së tyre.

3.2.1 Themelimi dhe funksionalizimi i Bordit për të Drejtat e Njeriut të sëmurëve psikiatrik, në nivel të Zyres së Shëndetit Mendor të Ministrisë së Shëndetësisë.

3.5 Sigurimi i funksionalitetit të plotë të SHPSHMK.

Për çdo objektiv janë përcaktuar edhe indikatorët e përmbushjes. Me këtë dokument janë përcaktuar poashtu edhe prioritetet sipas viteve për periudhën 2008 – 2013; mbikqyrja e zbatimit dhe projektioni i detalizuar buxhetor për zbatimin e saj.

Plani strategjik i shëndetit mendor të Kosovës (2001) shënoi fillimin e ndryshimit të gjendjes në lëminë e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë. Me këtë Plan, krahas konceptit biologjik (medicinal) të organizimit u përvetësua edhe koncepti psikosocial i parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit të sëmundjeve dhe çrregullimeve psikiatrike. Shërbimet, ekskluzivisht psikiatrike dhe spitalore lëvizën kah shërbimet multidisiplinare që ofrohen në mjedisin ku jetojnë të sëmurët psikiatrik, ndërsa puna kryekëputë individuale filloi të shoqërohet me mbështetjen e familjeve të të sëmurëve psikiatrik. Duke e reflektuar realitetin psikosocial të Kosovës së pasluftës, plani si prioritet përcaktoi përkujdesin për të sëmurët kronik psikiatrik. Plani mundësoi zhvillimin e resurseve të reja njerëzore dhe institucionale, ndërsa me Ligjin e shëndetësisë dhe aktet përcjellëse nënligjore u vu baza ligjore për funksionimin e shërbimit profesional të shëndetit mendor të Kosovës si shërbim i parë profesional, në nivel të vendit (në tekstin e mëtejme, SHPSHMK). Shërbimi ka organizim administrativ, në bazë territoriale me shtatë struktura të ndërlidhura funksionale, që ofrojnë shërbime të integruara, multidisiplinare, në tri nivele të kujdesit për shëndetin mendor duke mbështetur klientin dhe familjen e tij, nëpërmjet vënjes në funksion të resurseve të bashkësisë ku ai jeton.³ Puna e SHPSHMK mbështetet në parimet, si vijon: përmbushja e nevojave reale në territorin përfshirës; cilësia e shërbimeve; qasja adekuate; jo-diskriminimi; koordinimi dhe gjithëpërfshirja; mbështetja e familjes; besueshmëria; respektimi dhe përkrahja e dinjitetit, autonomisë, integritetit dhe mëvetësisë së shfrytëzuesve të

shërbimeve; si dhe koordinimi me shërbimet e mjekësisë familjare dhe shërbimet e përkujdesit social, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së marrëdhënies terapeutike.

Reforma e shërbimeve të shëndetit mendor në Kosovë u mbështet në mënyrë sistematike në tërë periudhën e pasluftës nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh), dhe shumë institucione dhe organizata të tjera akademike dhe donatore, qeveritare dhe joqeveritare, vendore dhe ndërkombëtare. Ndryshimet e arritura, shënuan avansim të qartë krahasuar me gjendjen e këtyre shërbimeve në shtetet fqinje. Në mes të tjerave, hulumtimet e bëra dëshmojnë uljen e dukshme të numrit të hospitalizimeve në repartet psikiatrike⁴ si dhe përmirësimin e kualitetit të punës me të sëmuret psikiatrik. Megjithatë, përkundër të arriturave evidente situata lenë, ende shumë për të dëshiruar.¹⁰

-I- QËLLIMI

Qëllimi i këtij punimi është që të kuptohen qëndrimet e nxënësve të shkollave të mesme ndaj pacientëve psikiatrik (stigmatizmi), përkatësisht sjelljet e njerëzve ndaj pacientëve me probleme të shëndetit mendor dhe trajtimit të tyre.

Objektivat:

- Të përshkruajmë karakteristikat e shëndetit mendor dhe të problemeve mendore
- Të diskutohet roli dhe rëndësia e mediave në keq (infomimin) e shoqërisë mbi njerëzit me probleme mendore
- Të përshkruhen aftësitë e personelit shëndetësor në trajtimin e pacientëve me probleme mendore
- Të vlerësohen perceptimet e nxënësve të shkollave të mesme mbi problemet mendore dhe stigmën lidhur me to

¹⁰ Ministria e Shëndetësisë, Strategjia e Shëndetit Mendor të Kosovës 2008- 2013, Dhjetor, 2007, Prishtinë.

- Të diskutohen mënyrat dhe metodat se si mund të luftohet stigma nga problemet mendore.

-II- METODOLOGJIA

Studimi përbëhet nga dy komponenta:

Shqyrtimi i literaturës në lidhje me problemet mendore dhe stigmatizmin si pasojë e sëmundjes, dhe vlerësimi i perceptimeve të adoleshentëve mbi stigmatizmin tek personat me probleme të shëndetit mendor në qytetin e Prizrenit.

Me qëllim që të kuptojmë njohuritë e adoleshentëve mbi sëmundjet mendore dhe stigmën si koncept realizuam anketën e cila përmbanë pyetje të cilat na mundësuan të kuptojmë se sa nxënësit dinë rreth stigmës, si dhe sa pranojnë apo pranojnë në shoqëri një individ me sëmundje mendore. Anketa u realizua me 120 nxënës të shkollës së mesme ' Luciano Motroni ' Prizren, duke përfshirë nga 40 nxënës në 3 drejtime të ndryshme të mjekësisë. Anketa u realizua gjatë muajit mars 2017.

Për anketimin e adoleshentëve fillimisht është marrë leje për realizimin e studimit në shkollën përkatëse dhe gjithashtu është kërkuar edhe pëlqimi i çdo nxënësi të përfshirë në studim dhe secili paraprakisht është njoftuar me objektivat e hulumtimit dhe është lutur për pjesëmarrje në studim. Përzgjedhja e mostrës ka qenë e rastësishme.

Anketimi është bërë me anë të pyetësorit që përmbanë pyetje të cilat kanë të bëjnë lidhje me atë se sa personat me çrregullime mendore pranohen nga të rinjët apo diskriminohen nga shoqëria duke përfshirë çështje si: kush mendoni se mund të preket me probleme të shëndetit mendor, sa u afrohet ndihmë të afërmëve apo miqve me probleme të shëndetit mendor, a do të ndiheshit në siklet t’i tregonit dikujt që keni pasur probleme të shëndetit mendor, sa do ta pranoni në shkollën tuaj apo në vendin e punës një të sëmurë me probleme të shëndetit mendor, sa i konsideroni të dhunshëm njerëzit me probleme të shëndetit mendor, ku duhet të kërkojë ndihmë një i sëmurë me probleme mendore, a i mendoni si fjalë fyese apo si shaka fjalët si “ psiko” , “i çmendur” , “ i luajtur”, a mendoni se çrregullimet mendore nuk përmirsohen pavarësisht trajtimeve që marrin, etj.

Analiza statistikore e të dhënave është bërë në programin Excel. Rezultatet janë prezantuar në formë tabelash dhe grafikonesh.

-III- REZULTATET

Me qëllim që të kuptojmë njohuritë e adoleshentëve mbi sëmundjet mendore dhe stigëm si koncept realizuam anketën e cila përmbanë pyetje të cilat na mundësuan të kuptojmë se sa nxënësit dinë rreth stigmës, sa pranohen apo pranojnë në shoqëri një individ me sëmundje mendore. Anketa u realizua me 120 nxënës të shkollës së mesme ‘ Luciano Motroni’ Prizren, duke përfshirë nga 40 nxënës në 3 drejtime të ndryshme të mjeksisë. Anketa u realizua gjatë muajit Mars, 2017. Rezultatet e nxënësve të anketuar u paraqiten në formë tabelash dhe grafikonesh.

Të dhënat e përgjithshme të nxënësve të anketuar

Gjinia		
Femër	90	75%
Mashkull	30	25%
Mosha		
16- 17	30	25%
18+	90	75%
Klasa e nxënësve të anketuar		
12	120	100%
Drejtimit e nxënësve të anketuar		
Infermieri	40 nxënës	
Mami	40 nxënës	
Farmacit	40 nxënës	

Çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor

Në tabelën 1. dhe grafikonin 1. janë paraqitur rezultatet e nxjerrura nga nxënësit e anketuar, pyetja kishte të bënte në lidhje me shëndetin mendor, se a mendojnë fëmijët dhe adoleshentët që çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor. Nga rezultatet arritëm të kuptojmë që nga drejtimi infermieri, 12 apo 30% të nxënësve mendojnë që po, çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor, 20 apo 50% të nxënësve mendojnë që ndoshta mund çdo kush të ketë probleme të shëndetit mendor kurse 8 apo 20% të nxënësve mohojnë që çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor. Nga drejtimi mami, 8 apo 20% të nxënësve mendojnë që çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor, 20 apo 50% të nxënësve mendojnë që ndoshta çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor kurse 12 apo 30% të nxënësve mohojnë që çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor, kurse nga drejtimi farmaci 4 apo 10% mendojnë që çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor, 24 apo 60% të nxënësve mendojnë që ndoshta po, kurse 12 apo 30% të nxënësve mohojnë që çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor.

Tabela 1. Çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	12	30%	20	50%	8	20%
Mami	8	20%	20	50%	12	30%
Farmacii	4	10%	24	60%	12	30%

Grafikoni 1. Çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor

Me problemet e shëndetit mendor mund të preken vetëm të rriturit e jo të rinjtë (adoleshentët) dhe fëmijët

Në tabelën 2. dhe grafikonin 2. janë paraqitur rezultatet e nxjerrura nga nxënësit e anketuar, pyetja kishte të bënte në lidhje me sëmundjen mendore, se kjo sëmundje a mund të gjendet vetëm tek të rriturit apo edhe te fëmijët dhe adoleshentët. Nga rezultatet arritëm të kuptojmë që nga drejtimi infermieri, 16 nxënës apo 40% mendojnë që sëmundjet mendore prekin vetëm të rriturit e jo fëmijët dhe adoleshentët, 14 apo 35% thanë që ndoshta po, duke mos dhënë një përgjigje definitive, kurse 10 nxënës apo 25% thanë që me probleme të shëndetit mendor mund të preken fëmijët, adoleshentët dhe të rriturit. Nga drejtimi mami, 22 nxënës apo 55% mendojnë që sëmundjet mendore prekin vetëm të rriturit e jo fëmijët dhe adoleshentët, 10 apo 25% thanë që ndoshta mund të ndodh vetëm tek të rriturit, kurse 8 apo 20% thanë që sëmundjet mendore prekin të gjithë pa marrë parasysh moshën. Te drejtimi farmaci, 12 apo 30% të nxënësve menduan që sëmundjet mendore prekin vetëm të rriturit, 16 apo 40% thanë që ndoshta ka mundësi të prek vetëm të rriturit kurse 12 nxënës apo 30% mendojnë që sëmundjet mendore mund të gjenden tek individit pa marrë parasysh moshën.

Tabela 2. Me problemet e shëndetit mendor mund të preken vetëm të rriturit e jo të rinjtë (adoleshentët) dhe fëmijët

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	16	40%	14	35%	10	25%
Mami	22	55%	10	25%	8	20%
Farmacii	12	30%	16	40%	12	30%

Grafikoni 2. Me problemet e shëndetit mendor mund të preken vetëm të rriturit e jo të rinjët (adoleshentët) dhe fëmijët

Nëse një mik i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor, unë do t'a kisha ndihmuar atë.

Tek pyetja se sa do t'i kishit ndihmuar një miku nëse do të kishte probleme me shëndetin mendor, nga drejtimi infermieri 18 nxënës apo 45% u përgjigjën që do ta kishin ndihmuar mikun, 10 apo 25% u përgjigjën që ndoshta do ta kishin ndihmuar kurse 12 apo 30% të nxënësve raportuan që nuk do ta kishin ndihmuar një mik me probleme të shëndetit mendor. Nga drejtimi mami, 16 apo 40% të nxënësve raportuan që do ta kishin ndihmuar një mik më probleme të shëndetit mendor, 10 nxënës apo 25% raportuan që ndoshta do ta kishin ndihmuar kurse 15 apo 35% të nxënësve deklaruan që nuk do ta kishin ndihmuar. Nga drejtimi farmaci, 16 nxënës apo 40% thanë që do ta kishin ndihmuar një mik me sëmundje mendore, 18 apo 45% thanë që ndoshta do ta kishin ndihmuar kurse 8 apo 20% raportuan që nuk do ta kishin ndihmuar një mik me probleme të shëndetit mendor.

Tabela. 3. Nëse një mik i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor, unë do t'a kisha ndihmuar atë

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	18	45%	10	25%	12	30%
Mami	16	40%	10	25%	14	35%
Farmaci	16	40%	18	45%	8	20%

Grafikoni 3. Nëse një mik i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor, unë do t'a kisha ndihmuar atë.

Unë do të ndihesha shumë në siklet për t'i treguar dikujt se kam pasur ose kam një problem të shëndetit mendor

Që do të ndiheshin në siklet për t'i treguar dikujt nëse kanë apo kanë pasur probleme të shëndetit mendor në drejtimin infermieri u përgjigjen 18 nxënës apo 45% të nxënësve të anketuar, ndoshta u përgjigjen 10 nxënës apo 30% të nxënësve të anketuar kurse jo thanë 12 apo 30% të nxënësve. Nga drejtimi mami 18 apo 45% të nxënësve pranuan që do të ishin ndier në siklet për t'i treguar dikujt që ka pasur ose ka ndonjë problem të shëndetit mendor, 8 apo 20% të nxënësve thanë që ndoshta do të ishin ndjerë në siklet kurse 14 apo 35% raportuan që nuk do të ishin ndjerë në siklet kurse nga drejtimi farmaci 24 apo 60% nxënës raportuan që do të ishin ndjerë në siklet për t'i treguar dikujt që ka pasur ose ka probleme të shëndetit mendor, 8 apo 20% raportuan që ndoshta do të ishin ndjerë në siklet t'a pranonin që kanë pasur probleme të shëndetit mendor kurse 8 apo 20% të nxënësve raportuan që nuk do të ishin ndier në siklet, ta pranonin problemin me sëmundje mendor

Tabela 4. Unë do të ndihesha shumë në siklet për t'i treguar dikujt se kam pasur ose kam një problem të shëndetit mendor

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	18	45%	10	25%	12	30%
Mami	18	45%	8	20%	14	35%
Farmaci	24	60%	8	20%	8	20%

Grafikoni 4. Unë do të ndihesha shumë në siklet për t'i treguar dikujt se kam pasur ose kam një problem të shëndetit mendor.

Unë do të jem i/e lumtur nëse në shkollën time ose në vendin e punës do të kem dikë me probleme të shëndetit mendor

Se do të ndiheshin të lumtur nëse në shkollë do të kishin nxënës me probleme të shëndetit mendor pranuan 12 nxënës apo 30% të nxënësve të anketuar nga drejtimi infermieri, ndoshta thanë 14 nxënës apo 35%, kurse jo thanë 14 nxënës apo 35% të anketuar nga drejtimi infermieri kurse nga drejtim mami 10 apo 25% të nxënësve raportuan që nuk do të ishte i lumtur nëse do të kishte nxënës me sëmundje mendore, ndoshta thanë 12 nxënës apo 30% kurse jo thanë 18 apo 45% të nxënësve të anketuar. Nga drejtimi farmaci 8 nxënës apo 20% raportuan që do të ishin të lumtur nëse në shkollë do të kishte nxënës me probleme mendore, 16 nxënës apo 40%

raportuan që ndoshta kurse 14 apo 35% raportuan që nuk do të ishin ndier të lumtur nëse do të kishin pasur në shkollë nxënës me probleme të shëndetit mendor.

Tabela. 5. Unë do të jem i/e lumtur nëse në shkollën time ose në vendin e punës do të kem dikë me probleme të shëndetit mendor.

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	12	30%	14	35%	14	35%
Mami	10	25%	12	30%	18	45%
Farmacit	8	20%	16	40%	14	35%

Grafikoni 5. Unë do të jem i/e lumtur nëse në shkollën time ose në vendin e punës do të kem dikë me probleme të shëndetit mendor.

Njerëzit me probleme të shëndetit mendor shpesh herë dinë të jenë të dhunshëm

Nga drejtimi infermieri 14 nxënës apo 35% mendojnë që njerëzit me sëmundje mendore janë të dhunshëm, ndoshta janë të dhunshëm mendojnë 16 apo 40% të nxënësve kurse që njerëzit me probleme shëndetsore dinë të jenë të dhunshëm nuk u pajtuan 10 nxënës apo 25% nga drejtimi infermieri. Nga drejtimi mami 12 nxënës apo 30% mendojnë që njerëzit me probleme shëndetsore shpesh janë të dhunshëm, 14 apo 35% mendojnë që ndoshta kurse 14 apo 35% nuk pajtohen me këtë mendim. Nga drejtimi farmaci 10 nxënës apo 25% mendojnë që pacientët me sëmundje mendore dinë të jenë të dhunshëm, 12 apo 30% thonë që ndoshta kurse 18 apo 45% nuk pajtohen me këtë mendim

Tabela. 6. Njerëzit me probleme të shëndetit mendor shpesh herë dinë të jenë të dhunshëm

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	14	35%	16	40%	10	25%
Mami	12	30%	14	35%	14	35%
Farmacit	10	25%	12	30%	18	45%

Grafikoni 6. Njerëzit me probleme të shëndetit mendor shpesh herë dinë të jenë të dhunshëm

Në qoftë se unë do të kisha një problem të shëndetit mendor do të dija se si duhet marrë ndihmë

Nga drejtimi infermieri 14 apo 35% të nxënësve raportuan që dinë se si duhet të marrin ndihmë nëse do të kishin probleme të shëndetit mendor, ndoshta dinë të marrin ndihmë raportuan 16 apo 40% të nxënësve të anketuar, që nuk dinë se si duhet të marrin ndihmë deklaruan 10 nxënës apo 25% të nxënësve të anketuar, nga drejtimi mami 20 apo 50% të nxënësve deklaruan që dinë se si duhet të marrin ndihmë në rast të problemit me shëndetin mendor, 12 apo 30% të nxënësve raportuan që ndoshta dinë kurse 8 nxënës apo 20% deklaruan që nuk dinë se si duhet marrur ndihmë, nga drejtimi farmaci 14 apo 35% të nxënësve të anketuar deklaruan se dinë se si duhet marrur ndihmë në rast të problemit me shëndetin mendor, 14 apo 35% raportuan që ndoshta dinë se si duhet marrur ndihmë kurse 12 apo 30% deklaruan se nuk dinë se si duhet marrur ndihmë në rast problemi me shëndetin mendor.

Tabela 7. Në qoftë se unë do të kisha një problem të shëndetit mendor do të dija se si duhet marrë ndihmë.

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	14	35%	16	40%	10	25%
Mami	20	50%	12	30%	8	20%
Farmaci	14	35%	14	35%	12	30%

Grafikoni 7. Në qoftë se unë do të kisha një problem të shëndetit mendor do të dija se si duhet marrë ndihmë

Duke përdorur fjalë të tilla etiketuese si "psiko", "i çmendur", "i luajtur", etj., është vetëm një shaka e vogël, askush nuk duhet për t'u lënduar

Nga drejtimi infermieri 16 apo 40% të nxënësve deklaruan që fjalët fyese duhet marrur si shaka e nuk është asgjë për t'u lënduar, 12 apo 30% të nxënësve të anketuar lajmëruan që ndoshta duhet

marrur si shaka, dhe 12 apo 30% të nxënësve të anketuar raportuan që me fjalët fyese njerëzit lëndohen, nga drejtimi mami 16 apo 40% të nxënësve të anketuar raportuan se këto fjalë fyese duhet marrur vetëm si shaka, 14 apo 35% të nxënësve raportuan që ndoshta duhet marrur si shaka kurse 10 apo 30% të nxënësve raportuan që këto fjalë fyese i lëndojnë njerëzit, nga drejtimi farmaci 20 apo 50% të nxënësve raportuan që fjalët e tilla fyese duhet marrur si për shaka, 10 apo 25% raportuan që ndoshta duhet marrur si për shaka kurse 10 apo 20% të nxënësve raportuan që me fjalë të tilla njerëzit mund të lëndohen.

Tabela 8. Duke përdorur fjalë të tilla etiketuese si "psiko", "i çmendur", "i luajtur", etj., është vetëm një shaka e vogël, askush nuk duhet për t'u lënduar.

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	16	40%	12	30%	12	30%
Mami	16	40%	14	35%	10	25%
Farmaci	20	50%	10	25%	10	25%

Tabela 8. Duke përdorur fjalë të tilla etiketuese si "psiko", "i çmendur", "i luajtur", etj., është vetëm një shaka e vogël, askush nuk duhet për t'u lënduar.

Çrregullimet mendore nuk përmirësohen pavarësisht trajtimeve që marrin

Çrregullimet mendore nuk mund të përmirësohen pavarësisht trajtimit që marrin, mendojnë 10 apo 25% të nxënësve të anketuar nga drejtimi infermieri, ndoshta nuk përmirësohen deklaruar 14 apo 35% të studentëve të anketuar kurse nuk pajtohen me këtë hipotezë 16 apo 40% të nxënësve të anketuar nga drejtimi infermieri, nga drejtimi mami 12 apo 30% të nxënësve pajtohen se çrregullimet mendore nuk mund të përmirësohen pavarësisht trajtimeve, 18 apo 45% thonë që ndoshta nuk përmirësohen kurse 10 apo 25% të nxënësve nuk pajtohen duke mohuar që trajtimet nuk ndikojnë në përmirësimin e çrregullimeve shëndetsore, nga drejtimi farmaci 16 nxënës apo 40% mendojnë që kjo hipotezë është e saktë, 14 apo 35% thonë që ndoshta çrregullimet mendore nuk përmirësohen pavarësisht trajtimeve dhe 10 apo 25% mendojnë që trajtimet përmirësojnë çrregullimet mendore.

Tabela 9. Çrregullimet mendore nuk përmirësohen pavarësisht trajtimeve që marrin

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	10	25%	14	35%	16	40%
Mami	12	30%	18	45%	10	25%
Farmacii	16	40%	14	35%	10	25%

Grafikoni 9. Çrregullimet mendore nuk përmirësohen pavarësisht trajtimeve që marrin

Nëse një shok i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor unë do të qëndroja larg tij.

Nëse një shok do të kishte probleme të shëndetit mendor 14 apo 35% të nxënësve nga drejtimi infermieri do t'i qëndronin larg tij/saj, ndoshta do të qëndronin larg deklaruan 16 apo 40% të nxënësve kurse do t'i qëndronin afër 10 apo 25% të nxënësve të anketuar nga drejtimi infermieri, nga drejtimi mami 12 apo 30% të nxënësve të anketuar pranuan se do t'i qëndronin një shoku me probleme të shëndetit mendor, 14 apo 35% deklaruan që ndoshta kurse që nuk pranuan që do t'i qëndronin larg ishin 14 apo 35% të nxënësve të anketuar nga drejtimi mami, nga drejtimi farmaci 8 apo 20% të nxënësve të anketuar pranuan që do t'i qëndronin larg shokëve me probleme të shëndetit mendor, ndoshta do t'i qëndronin larg deklaruan 10 apo 25% kurse që nuk pranuan t'i qëndronin larg ishin 22 apo 55% të nxënësve të anketuar.

Tabela. 10. Nëse një shok i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor unë do të qëndroja larg tij.

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	14	35%	16	40%	10	25%
Mami	12	30%	14	35%	14	35%
Farmacii	8	20%	10	25%	22	55%

Grafikoni 10. Nëse një shok i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor unë do të qëndroja larg tij.

Termi "çrregullim mendor" më bën të ndihem në siklet

Se sa ndihen në siklet nga termi çrregullim mendor 18 apo 45% të nxënësve nga drejtimi infirmieri pranojnë që ky term i bënë të ndihen në siklet, 6 apo 45% thanë që deri diku kurse 16 apo 40% raportuan që ky term nuk i bënë të ndihen në siklet, nga drejtimi mami 12 apo 30% të nxënësve raportuan që ky term i bënë të ndihen në siklet, 14 apo 35% thanë që deri diku kurse 14 apo 35% raportuan që nuk ndihen në siklet kur dëgjojnë këtë term, nga drejtimi farmaci 10 apo 25% të nxënësve raportuan se ndihen në siklet nga ky term, ndoshta raportuan 18 apo 45% të nxënësve kurse nuk ndihen në siklet deklaruan 12 apo 30% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Tabela. 11. Termi "çrregullim mendor" më bën të ndihem në siklet.

	Po		Ndoshta		Jo	
Infirmieri	18	45%	6	15%	16	40%
Mami	12	30%	14	35%	14	35%
Farmaci	10	25%	18	45%	12	30%

Grafikoni 11. Termi "çrregullim mendor" më bën të ndihem në siklet

Individët të cilët diagnostifikohen me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës

Nga drejtimi infirmieri 12 apo 30% të nxënësve mendojnë që individët me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës, 16 apo 40% thonë që ndoshta vuajnë gjithmonë kurse 12 apo 30% nuk mendojnë që këto simptoma do të mbesin gjithmonë, nga drejtimi mami 14 apo 35% mendojnë që këto simptoma mbesin gjithmonë, ndoshta thanë 14 apo 35% të nxënësve kurse nuk u pajtuan 12 apo 30% të nxënësve, nga drejtimi farmaci 8 apo 20% të nxënësve mendojnë që individët me sëmundje mendore vuajnë gjithmonë nga simptomat, 10 apo 25% mendojnë që ndoshta këto simptoma zgjasin gjithmonë kurse nuk pajtohen 22 apo 55% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Tabela 12. A mendoni se individët të cilët diagnostifikohen me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	12	30%	16	40%	12	30%
Mami	14	35%	14	35%	12	30%
Farmacii	8	20%	10	25%	22	55%

Grafikoni 12. Individët të cilët diagnostifikohen me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës

Një person me probleme të shëndetit mendor ka më pak gjasa të funksionoj si prind i mirë

Nga drejtimi infermieri, 12 apo 30% të nxënësve mendojnë që një individ me sëmundje mendore ka pak gjasa të funksionojë si prind i mirë, 8 apo 20% të nxënësve thonë që ndoshta kurse 20 apo 50% nuk pajtohen me mendimin se personat me sëmundje mendore ka më pak gjasa të funksionoj si prind i mirë, nga drejtimi mami 10 apo 25% të nxënësve pajtohen me këtë mendim, 10 apo 25% thonë deri diku kurse 20 apo 50% nuk pajtohen me këtë mendim, nga drejtimi farmaci 16 apo 40% pajtohen me këtë mendim, 12 apo 30% thonë ndoshta kurse 12 apo 30% nuk pajtohen me këtë mendim.

Tabela 13. Një person me probleme të shëndetit mendor ka më pak gjasa të funksionoj si prind i mirë

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	12	30%	8	20%	20	50%
Mami	10	25%	10	25%	20	50%
Farmacii	16	40%	12	30%	12	30%

Grafikoni 13. Një person me probleme të shëndetit mendor ka më pak gjasa të funksionoj si prind i mirë

A keni pasur ju ndonjëherë problem të shëndetit mendor në jetën tuaj

Tek pyetja se a keni pasur ju ndonjëherë probleme të shëndetit mendor 6 nxënës apo 15% të të anketuarve nga drejtimi infermieri pranuan që po, 14 apo 35% thanë që deri diku kurse 20 apo

50% mohuan të kenë pasur probleme të shëndetit mendor, nga drejtimi mami 10 apo 25% pranuan që kanë pasur probleme me shëndetit mendor, 12 apo 30% thanë që deri diku kurse 18 apo 45% mohuan të kenë pasur probleme të kësaj natyre, nga drejtimi farmaci 6 apo 15% të nxënësve pranuan që kanë pasur probleme të tilla, 14 apo 30% thanë që deri diku kurse 20 apo 50% mohuan të kenë pasur probleme me shëndetin mendor.

Tabela. 14. A keni pasur ju ndonjëherë problem të shëndetit mendor në jetën tuaj.

	Po		Ndoshta		Jo	
Infermieri	6	15%	14	35%	20	50%
Mami	10	25%	12	30%	18	45%
Farmaci	6	15%	14	30%	20	50%

Grafikoni 14. A keni pasur ju ndonjëherë problem të shëndetit mendor në jetën tuaj.

Diskutimi

Në hulumtimin e realizuar me nxënësit e shkollës së mesme të mjeksisë ‘Luciano Motroni’ në Prizren, nga 3 drejtimet e ndryshme të mjeksisë duke përfshirë drejtimin infermieri, mami dhe farmaci shumica e nxënësve mendojnë që ndoshta çdo njeri mund të ketë problem të shëndetit mendor. Nga kjo kuptohet se nxënësit nuk shprehen mjaftueshëm të sigurt duke lënë të nënkuptohet që njohuritë mbi sëmundjen mendore janë të mangta, shumica e nxënësve adoleshent nga drejtimi infermieri dhe mami pohojnë se sëmundjet mendore prekin vetëm të rriturit dhe jo adoleshentët kurse nga drejtimi farmaci thonë që ndoshta vetëm të rriturit e jo adoleshentët përgjigja e tyre ishte jo e saktë ndoshta duke mos dashur ta pranojnë pasiqë dhe veta janë adoleshentët apo nga njohurit e servuara jo të sakta dhe të pakta. Fatmirësisht, humaniteti i adoleshentëve nuk mungon pasiqë shumica e adoleshentëve nga 3 drejtimet e ndryshme pranuan se do t’a ndihmonin një mik nëse do të kishte probleme të shëndetit mendor. Shumica e adoleshentëve pranuan se do të ndiheshin në sikletë për t’i treguar dikujt se ka pasur problem të shëndetit mendor. Adoleshentët nga 3 drejtimet e ndryshme raportuan se nuk do të ndiheshin të lumtur nëse në shkollën apo punën e tyre do të kishin dikë me problem të shëndetit mendor.

Nga njohuritë e pakta dhe të servuara në mënyrë adekuate shumica e nxënësve mendojnë që njerëzit me probleme të shëndetit mendor shpesh herë dinë të jenë të dhunshëm. Nxënësit raportuan që nëse do të kishin probleme të shëndetit mendor ndoshta do të dinin si të merrnin ndihmë, duke mos qenë të sigurt. Duke përdorur fjalë të tilla etiketuese si "psiko", "i çmendur", "i luajtur", shumica e nxënësve raportuan që këto fjalë nuk do të sjellnin ndonjë problem pasiqë mund të jenë në kuadër të shakave. Shumica e nxënësve raportuan që çrregullimet mendore nuk përmirsohen pavarësisht trajtimëve që marrin ku edhe nga kjo kuptojmë njohuritë e pakta të nxënësve. Nxënësit nuk pranuan që nëse do të kishin një mik/e me problem të shëndetit mendor t'i qëndronin larg tij/saj. Nga drejtimi mami shumica e nxënësve raportuan që termi "çrregullim mendor" i bënë të ndihen në siklet, kurse nga drejtimet mami dhe farmaci thanë që ndoshta i bënë të ndihen në siklet. Shumica e nxënësve mendojnë që individët që vuajnë nga sëmundjet mendore vuajnë nga simptomet e tyre gjatë gjithë jetës. Shumica e nxënësve mendojnë se një person me probleme të shëndetit mendor nuk mund të funksionoj si një prind i mirë. Shumica e nxënësve nga 3 drejtimet raportuan që nuk kanë pasur problem të shëndetit mendor asnjëherë deri më tani.

Përfundimi

Nga rezultatet e anketimit në lidhje me njohuritë e adoleshentëve në lidhje me sëmundjen mendore dhe stigmën si koncept më i gjerë, ndikimi i stigmës tek nxënësit në shkollën e mesme të mjeksisë 'Luciano Motroni' në Prizren, janë nxjerrë këto konkluzione:

Se çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor menduan 30% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 20% nga drejtimi mami dhe 10% nga drejtimi farmaci. Që ndoshta çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor raportuan 50% nga drejtimi infermieri poshatu dhe nga drejtimi mami kurse 60% nga drejtimi farmaci. Më duhet se çdo kush mund të ketë probleme të shëndetit mendor raportuan 20% nga drejtimi infermieri dhe 30% nga drejtimi mami dhe farmaci.

Sa i përket pyetjes mbi njohuritë e nxënësve mbi sëmundjen mendore se me probleme të shëndetit mendor mund të preken vetëm të rriturit e jo të rinjtë (adoleshentët) dhe fëmijët, me këtë deklaratë u pajtuan 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 55% nga drejtimi mami si dhe

30% nga drejtimi farmaci. Ndoshta kjo fjali është e saktë menduan 35% nxënës nga drejtimi infirmieri, 25% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 40% nga drejtimi farmaci. Kurse me këtë mendim nuk u pajtuan 25% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, 20% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 30% nga drejtimi farmaci.

Se sa do t'a ndihmonin një mik me probleme të shëndetit mendor nga drejtimi infirmieri 45% të nxënësve raportuan që do t'a ndihmonin nga drejtimi mami 40% dhe nga drejtimi farmaci 40% të nxënësve raportuan që po, ndoshta do ta ndihmonin raportuan 25% të nxënësve nga drejtimi infirmieri si dhe 25% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 45% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Kurse nuk do ta ndihmonin u përgjigjen 30% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 20% nga drejtimi farmaci.

Se a do të ndiheshin në siklet për t'i treguar dikujt që nxënësit kanë pasur ose kanë probleme të shëndetit mendor, nga drejtimi infirmieri që po u përgjigjen 45% të nxënësve, nga drejtimi mami 45% të nxënësve dhe nga drejtimi farmaci 60% të nxënësve. Kurse ndoshta do të ndiheshin në siklet raportuan 25% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, 20% të nxënësve nga drejtimi mami dhe nga drejtimi farmaci 20%. Që nuk do të ndiheshin në siklet për t'i treguar dikujt që kanë pasur ose kanë problem të shëndetit mendor raportuan 30% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, nga drejtimi mami 35% të nxënësve kurse nga drejtimi farmaci 20% të nxënësve.

Se a do të ndiheshin të lumtur nëse në shkollë apo vendin e punës do të kishin dikë me probleme të shëndetit mendor, po u përgjigjen 30% nga drejtimi infirmieri, 25% të nxënësve nga drejtimi mami kurse nga drejtimi farmaci 20% të nxënësve. Ndoshta do të ndiheshin të lumtur deklaruan 35% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, 30% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 40% nga drejtimi farmaci. Kurse nuk do të ndiheshin të lumtur raportuan 35% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, 45% të nxënësve nga drejtimi mami kurse 35% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Njerëzit me probleme të shëndetit mendor shpesh herë dinë të jenë të dhunshëm pohuan 35% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, 30% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Ndoshta njerëzit me probleme të shëndetit mendor shpesh herë dinë të jenë të dhunshëm raportuan 40% të nxënësve nga drejtimi infirmieri, 35% të nxënësve nga drejtimi

mami dhe 30 % nga drejtimi farmaci kurse nuk u pajtuan 25% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 45% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Pyetja që i'u bë nxënësve që nëse do të kishin probleme të shëndetit mendor, a do të dinin si të kërkonin ndihmë, nga drejtimi infermieri 35% të nxënësve u përgjigjen që po do të dinin gjithashtu që do të dinin si të kërkonin ndihmë u përgjigjën 50% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 35% nga drejtimi farmaci. Ndoshta do të dinin se si duhet marrur ndihmë u përgjigjën 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 30% nga drejtimi mami dhe 35% nga drejtimi farmaci. Kurse 25% të nxënësve nga drejtimi infermieri pranuan që nuk do të dinin se si duhet marrur ndihmë nëse do të kishin probleme të shëndetit mendor, nga drejtimi mami 20% kurse nga drejtimi farmaci 30% pranuan që nuk dinë si të kërkojnë ndihmë nëqoftëse do të kishin probleme të shëndetit mendor.

Fjalë të tilla etiketuese si "psiko", "i çmendur", "i luajtur", etj., është vetëm një shaka e vogël, askush nuk duhet të lëndohet sipas 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri gjithashtu 40% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 50% nga drejtimi farmaci. Ndoshta këto fjalë etiketuese duhet të merren vetëm si një shaka e jo të ofendohet dikush raportuan 30% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Këto fjalë etiketuese nuk duhet të përdoren sepse mund të lëndojnë një apo disa individë raportuan 30% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 25% të nxënësve nga drejtimi mami poashtu edhe 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Çrregullimet mendore nuk përmirësohen pavarësisht trajtimeve që marrin mendojnë 25% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 30% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 40% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Ndoshta këto çrregullime nuk përmirësohen pavarësisht trajtimeve që marrin mendojnë 35% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 45% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 35% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Nxënësit që mohuan që trajtimet nuk përmirësojnë çrregullimet mendore ishin 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 25% të nxënësve nga drejtimi mami poashtu 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

35% të nxënësve nga drejtimi infermieri pranuan që nëse një shok do të kishtë probleme të shëndetit mendor do ti qëndronin larg poashtu gjithashtu pranuan edhe 30% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 20% të nxënësve nga drejtimi farmaci, ndoshta një shoku me probleme të shëndetit mendor do t'i qëndronin larg raportuan 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Nxënësit që nuk pranuan t'i qëndronin larg një shoku pavarësisht problemeve me shëndetin mendor ishin 25% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 55% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Se termi "çrregullim mendor" i bënë të ndihen në siklet raportuan 45% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 30% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Ndoshta ky term do ti bënte të ndihen në siklet raportuan 15% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 45% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Kurse termi çrregullim mendor nuk i bënë të ndihen në siklet 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 30% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Individët të cilët diagnostifikohen me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës sipas 30% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 20% të nxënësve nga drejtimi farmaci, ndoshta individët të cilët diagnostifikohen me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës sipas 40% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 35% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 25% të nxënësve nga drejtimi farmaci kurse nxënësit që nuk pajtohen që individët të cilët diagnostifikohen me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës janë 30% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 30% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 55% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

30% të nxënësve nga drejtimi infermieri mendojnë që një individ me probleme të shëndetit mendor ka më pak gjasa të funksionojë si një prind i mirë këtë mendim kanë edhe 25% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 40% të nxënësve nga drejtimi farmaci, ndoshta një individ me probleme të shëndetit mendor nuk mund të funksionojë si prind i mirë mendojnë 20% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 25% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 40% të nxënësve nga drejtimi farmaci. Kurse me këtë fjali nuk pajtohen 50% të nxënësve nga drejtimi infermieri poashtu 50% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 30% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

15% të nxënësve nga drejtimi infermieri pruan që kanë pasur probleme të shëndetit mendor gjithashtu pruan edhe 25% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 15% të nxënësve nga drejtimi farmaci, ndoshta kanë pasur probleme të shëndetit mendor thanë 35% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 30% të nxënësve nga drejtimi mami poashtu 30% të nxënësve nga drejtimi farmaci, kurse mohuan që kanë pasur ndonjëherë probleme të shëndetit mendor raportuan 50% të nxënësve nga drejtimi infermieri, 45% të nxënësve nga drejtimi mami dhe 50% të nxënësve nga drejtimi farmaci.

Rekomandimet

Duke qenë se radioja dhe televizioni janë burimet kryesore të informacionit për popullatën, është shumë i rëndësishëm përdorimi i medias si një mjet edukativ dhe informativ për publikun e gjerë.

Fushata informuese dhe programe anti-stigma për publikun, si dhe aktivitete anti-stigma për grupe specifike të popullatës, duhet të ndërmerren nga shteti.

Duke qenë se mbështetja shoqërore dhe familjare janë njohur si faktorë mbrojtës të shëndetit mendor nga shumica e të intervistuarve, është e nevojshme të njihet dhe rëndësia e mbështetjes profesionale. Në këtë mënyrë, barra që bie mbi familjarët si rrjedhojë e sëmundjes mendore do të lehtësohet dhe ata mund të kthehen në bashkëpunëtorë efikasë në hartimin e planit të përkujdesjes dhe ofrimin e shërbimeve.

Kontaktet personale pozitive me persona me probleme të shëndetit mendor kanë treguar të jenë mënyra më efektive për të reduktuar stigmën dhe diskriminimin, ndaj duhet të jenë dhe pjesë përbërëse e çdo aktiviteti që ka për qëllim përmirësimin e qëndrimeve dhe njohurive të popullatës. Fushatat kombëtare të ndërgjegjësimit mbi të drejtat e njeriut duhet të përfshijnë dhe debate mbi të drejtat e barabarta që personat me probleme të shëndetit mendor duhet të zotërojnë.

Prandaj ne ofrojmë këto rekomandime:

- Rritja e ndërgjegjësimit të individëve mbi shëndetin dhe mirëqenien e tyre mendore
- Shtimi i njohurive të popullatës mbi shëndetin mendor dhe problemet e lidhura me të duke ndikuar pozitivisht qëndrimet dhe sjelljen
- Inkurajimi i individëve për të njohur rëndësinë dhe kërkuar mbështetjen shoqërore dhe profesionale.
- Niveli i ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e shëndetit mendor dhe eksperiencat personale në shëndet mendor
- Qëndrimet stigmatizuese dhe sjelljet diskriminuese
- Identifikimi i çrregullimeve mendore dhe përballja me to.

Referenca

1. Fatime Elezi, Eugjen Sotiri, Sonila Tomori, Florida Dobi 'Bazat e psikiatrisë', Cap - 1 -. Kujdesi infermieror në shëndetin mendor, fq. 18- 19, Tiranë, 2012.
2. Bukuroshe Hila, 'Shëndeti mendor dhe sistemi i drejtësisë penale', Tiranë- Shqipëri. <http://www.refraction.org.al/wp-content/uploads/2016/04/Guide-per-familjaret-e-individeve-me-probleme-te-shendetit-mendor.pdf>
3. OBSH (Zyra për Shqipëri), Studimi kombëtar mbi qëndrimet e publikut ndaj shëndetit mendor, Tiranë- Shqipëri, 2009. <http://klinika-venis.com/ver2/wp-content/uploads/2013/09/Q%C3%ABndrimet-e-Publikut-Ndaj-Sh%C3%ABndetit-Mendor-STUDIM-2009.pdf>
4. Gjergji M. Aleksi, Pirro Prifti, Vetima Murzaku, ' Psikologjia, Etika, Deontologjia mjekësore '. Cap – VII-. Aspektet psikologjike të zhvillimit të moshave njerëzore të ndryshme, normale dhe si pacientë të mjeksisë, fq. 114- 115, Tiranë, 2003
5. Dita Botërore e Shëndetit Mendor, Tetor, 2013

http://www.ishp.gov.al/multimedia/Kalendari_2013/Dita%20Boterore%20e%20Shendetit%20Mendor.pdf

6. Mindframe-media, 'Sëmundja mendore në media', Prill, 2012
<http://www.mindframe-media.info/for-media/reporting-mental-illness/evidence-and-research/evidence-about-mental-illness-in-the-media>
7. Kismet Baun, 'Roli i mediave në formimin e qëndrimeve ndaj sëmundjeve mendore', 2009. http://ontario.cmha.ca/wp-content/files/2012/07/moods_media_200812.pdf
8. Kristin Fawcett, 'Si keqinterpretohet sëmundja mendore në media? ', Prill, 2015.
<http://health.usnews.com/health-news/health-wellness/articles/2015/04/16/how-mental-illness-is-misrepresented-in-the-media>
9. Yanca Aracena, Një analizë e stigmës dhe portretizimi në filma, New York, 2012.
http://academicworks.cuny.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=1133&context=cc_etds_theses
10. Ministria e Shëndetësisë, Strategjia e Shëndetit Mendor të Kosovës 2008- 2013, Dhjetor, 2007, Prishtinë.

Biografi e shkurtër e kandidatës – CV (Curriculum Vitae)

Informatat personale:	
Emri dhe Mbiemri	Shqipe Krasniqi
Datëlindja	01. 05. 1981
Gjinia	Femër
Nr. Personal	1003149192
Të dhënat kontaktuese	
Nr. Tel:	+377 44413064
Adresa	Prizren
Emaili	shqipekrasniqi27@hotmail.com
Të dhënat e kualifikimit	

Shkolla e mesme e lartë	Shkolla e mesme e mjekësisë“ Luciano Motroni”
Universiteti	Universiteti i Gjakovës “ Fehmi Agani”
Fakulteti	Fakulteti i Mjekësisë
Programi	Infermieri
Statusi	E rregullt
Nr. ID	130306076

ANEKSI

Pyetëtori

Klasa: _____

Mosha : _____

Gjinia: F_ M_

Edukimi / Dega _____

Data: __/__/____

1.Çdokush mund të ketë një problem të shëndetit mendor.

Po Ndoshta Jo

2.Me problemet e shëndetit mendor mund të preken vetëm të rriturit e jo të rinjët (adoleshentët) dhe fëmijët.

Po Ndoshta Jo

3.Nëse një mik i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor, unë do t'a kisha ndihmuar atë.

Po Ndoshta Jo

4.Unë do të ndihesha shumë në siklet për t'i treguar dikujt se kam pasur ose kam një problem të shëndetit mendor.

Po Ndoshta Jo

5.Unë do të jem i/e lumtur nëse në shkollën time ose në vendin e punës do të kem dikë me probleme të shëndetit mendor.

Po Ndoshta Jo

6. Njerëzit me probleme të shëndetit mendor shpesh herë dinë të jenë të dhunshëm.

Po Ndoshta Jo

7.Në qoftë se unë do të kisha një problem të shëndetit mendor do të dija se si duhet marrë ndihmë.

Po Ndoshta Jo

8.Duke përdorur fjalë të tilla etiketuese si “ psiko “ , “i çmendur “ , “ i luajtur” etj., është vetëm një shaka e vogël , askush nuk duhet për t'u lënduar.

Po Ndoshta Jo

9.Çrregullimet mendore nuk përmirsohen pavarësisht trajtimeve që marrin.

Po Ndoshta Jo

10.Nëse një shok i imi do të kishte një problem të shëndetit mendor unë do të qëndroja larg prej tij.

Po Ndoshta Jo

11.Termi “ çrregullim mendor “ më bën të ndihem në siklet .

Po Ndoshta Jo

12. Individët të cilët diagnostifikohen me sëmundje mendore vuajnë nga simptomat e tyre gjatë gjithë jetës.

Po Ndoshta Jo

13. Një person me probleme të shëndetit mendor ka më pak gjasa të funksionoj si prind i mirë.

Po Ndoshta Jo

14. A keni pasur ju ndonjëherë problem të shëndetit mendor në jetën tuaj?

Po Ndoshta Jo